

UDHËZUES

SANKSIONET FINANCIARE NË LIDHJE ME TERRORIZMIN, FINANCIMIN E TERRORIZMIT
DHE FINANCIMIN E PËRHAPJES SË ARMËVE TË SHKATËRRIMIT NË MASË

I përditësuar

Maj 2020

HYRJE	4
VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	6
Financimi i terrorizmit	6
Financimi i armëve të shkatërrimit në masë	8
Çfarë janë sanksionet financiare	8
Si vendosen sanksionet	10
REKOMANDIMET NDËRKOMBËTARE TË FATF	10
Rekomandimi 6.....	10
Rekomandimi 7.....	11
NGRIRJA DHE NDALIMI I PËRDORIMIT TË FONDEVE DHE PASURIVE	12
Rëndësia e një regjimi efektiv bllokimi	12
Bllokimi sipas standarteve ndërkombëtare	13
Ngrirja sipas legjislacionit shqiptar.....	13
Përhapja e armëve të shkatërrimit në masë.....	15
Detyrimet e raportimit.....	16
Procesi i ankimimit	16
Procesi i heqjes nga lista	17
Qasja në fondet dhe pasuritë e tjera	18
Fondet dhe pasuritë që janë subjekt i bllokimit	19
RAPORTIMI I TË DHËNAVE	20
Cilësia dhe dobishmëria e të dhënave	20
Përputhshmëria dhe kontrolli	20
REZOLUTAT E OKB	20
Rezoluta 1267	21
Rezoluta 1373	21
Rezoluta 1452	21
Rezoluta 1540	22
Rezoluta 1718	22
Rezoluta 1737	23
Rezoluta 1747	23
MASAT PARANDALUESE DHE KOMUNIKIMI	23
ANEKS	25
Treguesit e financimit të terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë.....	25

HYRJE

Lufta kundër terrorizmit dhe financimit të tij, konsiderohet që prej sulmeve terroriste në Shtetet e Bashkuara në vitin 2001, një prioritet për të gjithë komunitetin ndërkombëtar. Si pasojë e sulmeve të vazhdueshme të kryera vitet e fundit në shumë qytete anembanë botës, fushëveprimi dhe natyra e kërcënimeve terroriste në nivel global, është intensifikuar në mënyrë të ndjeshme.

Një tjetër përparësi ndërkombëtare është ndalimi i krijimit dhe përdorimit të armëve të shkatërrimit në masë. Kjo shihet si një kërcënim në zhvillim, veçanërisht në lidhje me ngjarjet në disa vende të veçanta.

Në këto kushte një rëndësi të veçantë ka marrë, bashkërendimi në nivel ndërkombëtar i masave kundër financimit të terrorizmit dhe financimit të shpërndarjes së armëve të shkatërrimit në masë, si një mënyrë për të parandaluar kërcënimet që vijnë nga aktet terroriste si dhe për të kontribuar në forcimin e integritetit të sistemit ekonomiko-financiar dhe atij të sigurisë.

Kjo është një fushë në ndryshim të vazhdueshëm. Veçanërisht, terroristët dhe financuesit e tyre ndërmarrin vazhdimisht masa, me anë të të cilave synojnë të anashkalojnë instrumentet mbrojtëse të vendeve, duke shfrytëzuar teknologji të reja, marrëdhënie ekzistuese biznesi apo aktivitete të organizatave jo-fitimprurëse.

Në këtë kuadër, vendet kanë ndërmarrë vlerësime kombëtare të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në mënyrë që të kuptojnë tendencat, tipologjitë dhe burimet e reja të financimit të terrorizmit dhe metodat që përdorin organizatat terroriste për të administruar pasuritë e tyre. Një nga masat parandaluese, ka të bëjë me informimin e vazhdueshëm të subjekteve të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (PPP/FT), por edhe të individëve në përgjithësi, për detyrimet që ata kanë në këtë drejtim. Kjo është gjithashtu e nevojshme në lidhje me detyrimet për të luftuar financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë.

Forcimi i kapaciteteve parandaluese të institucioneve financiare, profesioneve të lira dhe çdo subjekti për legjislacionin PPP/FT dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë synon pikërisht të privojë personat dhe subjektet që përfshihen në aktivitete të tilla, nga fondet dhe pasuritë që mundësojnë ndërmarrjen e akteve terroriste ose krijimin dhe përdorimin e armëve të shkatërrimit në masë, të cilat çenojnë sigurinë në nivel kombëtar dhe global.

Në lidhje me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KSKB) ka miratuar rezolutat:

- 1267 (1999) dhe rezolutat pasardhëse të cilat ndahen dhe plotësojnë rezolutën 1267, duke përfshirë por jo kufizuar në rezolutat 1988 dhe 1989. Në terma të gjera, korniza origjinale u nda në kornizën 1267/1989 dhe 1988. Në funksion të këtij udhëzimi, shprehja “Korniza e Rezolutës 1267” përdoret për Rezolutën 1267 të KSKB dhe të gjitha rezolutat e saj pasardhëse;
- 1373 (2001);

Këto masa pasqyrojnë faktin se ka pasur një seri rastesh të terrorizmit dhe radikalizmit të individëve, të cilët gjithashtu janë përfshirë në zonat e konfliktit në Lindjen e Mesme dhe paraqesin një rrezik të konsiderueshëm në procesin e rekrutimit dhe sigurimit të burimeve financiare për persona të caktuar apo rrjete terroriste.

Në lidhje me financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, KSKB ka aprovuar rezolutat:

- 1540 (2004);
- 1718 (2006) dhe rezolutat pasardhëse (referuar në këtë dokument si kornizë e Rezolutës 1718 të KSKB);
- 1737 (2006) dhe rezolutat pasardhëse (referuar në këtë dokument si kornizë e Rezolutës 1737 të KSKB);

Rezoluta 1540 (2004), adresonte një nga boshllëqet në legjislacionin ndërkombëtar, që ka të bëjë me rrezikun që vjen nga përdorimi i armëve të shkatërrimit në masë nga aktorët jo shtetërorë. Kuadri i KSKB për Rezolutën 1718, vendosi masa kufizuese duke përfshirë sanksione financiare në përgjigje të shqetësimeve për përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë në Republikën Popullore Demokratike të Koresë (DPRK). Kuadri i KSKB për Rezolutën 1737, vendosi masa kufizuese, përfshirë ato financiare, në përgjigje të shqetësimeve për përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë në Iran.

Detyrimet e posaçme ndërkombëtare në lidhje me financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, janë reflektuar gjithashtu edhe në Rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimtimit Financiar (FATF - *Financial Action Task Force*).

Qëllimi i këtij udhëzuesi, të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), është të rrisë më tej nivelin e njohurive të subjekteve të ligjit PPP/FT, të përfshira në zbatimin e rezolutave ndërkombëtare të OKB, si dhe për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve në këtë fushë.

Duke vënë re rrezikun e lartë ndaj të cilit është ekspozuar sektori financiar dhe nevoja e veçantë e këtij sektori për komunikim dhe udhëzime në lidhje me ngrirjen e fondeve që u përkasin personave dhe subjekteve të shpallur, është e rëndësishme të theksohet se kërkesat e rezolutave të KSKB e shtrijnë efektin tek të gjithë personat dhe subjektet, të cilat janë të detyruar, të ngrijnë pa vonesë, fonde ose pasuri të tjera të personave të shpallur nga KSKB, sipas rezolutave të përmendura më lart dhe çdo rezolutë tjetër të miratuar më pas.

Duhet të theksohet se, ndonëse OKB mund të shpallë personat dhe subjektet sipas Rezolutës 1267, Rezolutës 1718 dhe 1737 të KSKB, ajo nuk mund të bëjë shpalljen për personat dhe subjektet sipas kornizës së Rezolutës 1373, sipas së cilës detyrimi për të ndërmarrë veprime pa vonesë nxitet nga një shpallje në nivel kombëtar, i paraqitur ose me inisiativën e vetë vendit ose bazuar në kërkesën e një vendi tjetër.

Përpjekjet për të luftuar financimin e terrorizmit dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, pengohen në mënyrë të konsiderueshme, në rast se vendet nuk ngrijnë shpejt dhe në mënyrë efektive fondet ose pasuritë e tjera të personave dhe subjekteve të shpallura. Krahas përpjekjeve të vendeve anëtare të OKB, për një regjim efektiv kundër financimit të terrorizmit dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, kërkohet dhe respektimi prej tyre i të drejtave të njeriut dhe mundësimi i një procesi objektiv të shpalljes, si dhe mbrojtja e të drejtave të palëve të treta në mirëbesim.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Sanksionet kundër individëve dhe subjekteve të dyshuar për mbështetjen e terrorizmit dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, përbëjnë një mekanizëm të rëndësishëm të programit të KSKB në këto fusha.

Ato vendosen sipas Kapitullit VII të Kartës së OKB dhe shtetet anëtare janë të detyruara të ndërmarrin një sërë masash, që ndër të tjera përfshijnë bllokimin e fondeve dhe të pasurive, ndalimin e udhëtimit dhe embargon e armëve ndaj personave apo subjekteve të shpallura, penalizimin e mbështetjes së terrorizmit dhe zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare.

Financimi i terrorizmit

Qëllimi kryesor i terrorizmit është që nëpërmjet akteve të dhunshme, të ndikojë në vendimmarrjen dhe sjelljen e qeverive, organizatave ndërkombëtare dhe shoqërive në përgjithësi. Një nga faktorët kryesor që e mundëson këtë fenomen, është financimi i tij nëpërmjet burimeve të ligjshme apo të jashtëligjshme.

Nëpërmjet financimit të terrorizmit, sigurohen fonde për aktivitete terroriste, të cilat mund të jenë nga burime të ligjshme, të tilla si, të ardhura nga biznesi, fonde shtetërore, dhurime personale të aktorëve privatë, individëve apo organizatave bamirëse. Kauzat e përbashkëta, janë arsyeja kryesore pse këto kategori subjektsh apo individësh zgjedhin të financojnë terroristët dhe grupet terroriste në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

Të ardhurat kriminale, që sigurohen nga tregtia e drogës, kontrabanda e armëve dhe mallrave të tjera, mashtrimet, rrëmbimet dhe grabitjet shërbejnë si burime alternative për financimin e terrorizmit. Si pasojë e luftës globale kundër terrorizmit të ndërmarrë gjatë dekadave të fundit, organizatat terroriste po mbështeten gjithnjë e më shumë në këto burime ilegale të financimit, duke nxjerrë në pah rrezikun e bashkëpunimit të tyre me grupet e krimit të organizuar.

Si çdo aktivitet kriminal, aktet terroriste kryhen në sajë të një kombinimi të një sërë faktorësh që lidhen me koston e operacionit të sulmit, pagesat për individët dhe familjet e tyre, mjetet e komunikimit, trajnimin, udhëtimet dhe logjistikën e sulmeve, të cilët të marrë në tërësinë e tyre kërkojnë burime financiare.

Për të shmangur vëmendjen e autoriteteve dhe për të mbrojtur identitetin e mbështetësve të tyre apo të përfituesve të fondeve, terroristët përdorin teknika të ngjashme me ato të pastrimit të parave¹. Përvoja ndërkombëtare dhe ajo vendase kanë treguar se transaksionet financiare që lidhen me financimin e terrorizmit priren të jenë në shuma modeste dhe në rastet kur terroristët sigurojnë fonde nga burime të ligjshme, gjë që e bën zbulimin dhe gjurmimin e këtyre fondeve më të vështirë.

Në ndryshim nga pastruesit e parave, terroristët nuk synojnë t'ju japin një formë të ligjshme pasurive me origjinë kriminale dhe si qëllim kryesor kanë shpërndarjen e fondeve për qëllime terroriste.

Për të siguruar lëvizjen e fondeve të tyre, financuesit e terrorizmit përdorin një sërë mënyrash që përfshijnë instrumentet financiare të sistemit bankar, sistemet informale të transferimit të vlerës dhe transportin fizik

¹ Pastrimi i parave kalon kryesisht në tre faza vendosje, shtresëzim dhe integrim.

të parave, instrumentet e negociueshme të pagesave, arin dhe sende të tjera me vlerë përmes pikave të kalimit kufitar.

Paraja për vetë anonimitetin e saj, përbën një instrument të preferuar për terroristët dhe mund të shkëmbehet më lehtë me mjete të tjera që mundësojnë financimin e akteve terroriste.

Organizatave terroriste ndryshojnë në përmasat, strukturën, objektivat dhe aftësitë operationale, motivimin dhe metodat e rekrutimit të tyre. Pavarësisht nga dallimet mes grupeve terroriste, si dhe midis terroristëve dhe mbështetësve të tyre, gjithmonë ekziston një nevojë e përbashkët për mjete financiare për kryerjen e akteve terroriste.

Kërkesat e organizatave terroriste për burime ekonomike dhe financiare të cilat përdoren për të ngritur dhe mbajtur infrastrukturën dhe personelin e nevojshëm, janë të konsiderueshme veçanërisht për ato organizata që kërkojnë të kontrollojnë territore² të caktuara. Për këtë qëllim, atyre ju duhet të sigurojnë një nivel të qëndrueshëm të fondeve. Prandaj, duhet të pranohet që jo vetëm shuma të vogla, mund të jenë të përfshira në marrëdhëniet me klientët ose transaksionet e krijuara për të mbështetur terrorizmin.

Organizatave terroriste, bazuar në objektivat dhe aftësitë e tyre operationale, mund të kenë prioritete të ndryshme, të cilat reflektohen dhe në metodat e përdorura për mbledhjen e fondeve, që gjithashtu ndryshojnë dhe evoluojnë gjatë ekzistencës së tyre.

Organizatave terroriste përdorin fondet e tyre kryesisht për:

Aktivitetin. Fonde dhe burimet ekonomike përdoren për fazën përgatitore apo kryerjen e sulmeve terroriste specifike. Në këtë aktivitet mund të përfshihen çështjet logjistike, blerja e armëve të lehta dhe bombave artizanale, falsifikimin e dokumenteve të identitetit dhe shpenzimet bazë (p.sh për strehimin, ushqimin dhe trajtimin mjekësor), si dhe korrierët për dërgimin e mesazheve apo transportin fizik të parave.

Propagandën dhe rekrutimin: Në funksion të rekrutimit të anëtarëve të rinj kërkohen fonde, që më pas shfrytëzohen duke përdorur rrjetet sociale, të cilat përveç rekrutimit shërbejnë dhe si një instrument efikas propagande dhe mbledhje fondesh. Përdorimi i internetit siguron një mekanizëm me kosto të ulët në fazat fillestare të rekrutimit ndërkohë që për hapat e mëtejshëm ka kosto shtesë.

Shfrytëzimi i mediave sociale për qëllime të rekrutimit dhe propagandës terroriste, është bërë një çështje prioritare për luftën kundër financimit të terrorizmit, pasi shumë organizata terroriste kanë shfrytëzuar mediat sociale për të siguruar fonde nga mbështetësit. Organizatave terroriste më komplekse, investojnë fonde të konsiderueshme në drejtim të operationeve të sofistikuar propagandistike, që përfshijnë botimin e revistave dhe gazetave, administrimin e faqeve të internetit dhe përdorimin e programeve audio-vizive për të promovuar mesazhet dhe pikëpamjet e tyre.

Trajnimi: Në këtë kuadër, fondet përdoren për të mundësuar trajnimin e anëtarëve dhe simpatizantëve në fushën e përdorimit të armëve dhe përgatitjen eksplozivëve artizanal. Trajnimi virtual, i ofruar përmes internetit është gjithashtu një mënyrë e njohur që po përdoret për të siguruar një numër në rritje të simpatizantëve.

² P.sh. Al-Kaida, ISIL, Boko Haram etj.

Pagat dhe kompensimi i anëtarëve: Disa nga fondet e organizatave terroriste, përdoren për pagesat e strukturave drejtuese, anëtarëve si dhe për pagesat e familjarëve (për anëtarët e burgosur ose të vdekur). PAGESA të tilla ndikojnë në forcimin e mëtejshëm të radhëve të organizatës dhe devocionin e anëtarëve ndaj qëllimeve dhe ideologjisë së organizatës.

Shërbime sociale: Grupet terroriste mund t'i përdorin burimet e tyre financiare dhe për të krijuar ose subvencionuar institucionet që ofrojnë shërbime shëndetësore, sociale dhe arsimore. Terroristët e bëjnë këtë, për të çenuar kredibilitetin e qeverive legjitime dhe për të fituar mbështetjen e popullatave lokale.

Në dallim nga organizatat e mëdha terroriste, celulat e vogla dhe terroristët individualë, përballen me probleme më modeste nga pikëpamja financiare, pasi kostot e sulmeve të tyre terroriste kërkojnë shuma relativisht të vogla. Mjetet financiare që përdoren prej tyre duhet të jenë të mjaftueshme për të siguruar ushqimin, strehimin, pajisjet e komunikimit, transportin dhe armët që përdorin për sulmet e tyre.

Bazuar në raportet ndërkombëtare, rreth 75% e 40 akteve terroriste të kryera në Evropë gjatë periudhës 1994 - 2013, kanë kushtuar më pak se 10 000 USD. Fondet janë përdorur kryesisht për blerjen e armëve, eksplozivëve, për udhëtimin dhe trajnimin.

Raportet ndërkombëtare tregojnë se terroristët dhe organizatat terroriste ndër të tjera përdorin dhe organizatat jo-fitimprurëse, për vetë mundësitë që ofrojnë rrjetet e tyre të bamirësisë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar duke:

- a) ndryshuar destinacionin e fondeve nëpërmjet punonjësve të OJF, që kanë lidhje me organizatat terroriste;
- b) shfrytëzuar autoritetin e drejtuesve të OJF për qëllime terroriste, përfshirë rekrutimin;
- c) abuzuar me programet e ndihmës dhe nivelin e ulët të auditimit të përdorimit të fondeve;

Raportet ndërkombëtare paraqesin veçanërisht me rrezik të lartë, OJF të cilat ofrojnë shërbime dhe e zhvillojnë aktivitetin e tyre pranë zonave të konfliktit.

Financimi i armëve të shkatërrimit në masë

Financimi i armëve të shkatërrimit në masë përfshin ofrimin e fondeve apo shërbimeve financiare në funksion të prodhimit, zhvillimit, blerjes, transferimit dhe eksportit të teknologjisë, mallrave, programeve, shërbimeve apo ekspertizës që mund të përdoret për programet e armëve nukleare, kimike apo biologjike, të cilat paraqesin rrezik për sigurinë globale.

Raportet ndërkombëtare, kanë nxjerrë në pah rrezikun që ekziston mbi lidhjen mes financimit të armëve të shkatërrimit në masë dhe terrorizmit, duke vënë theksin në nevojën e ndërmarrjes së masave efektive parandaluese të kontrollit, për vetë faktin që këto armë mund të shkaktojnë dëme katastrofike për njerëzimin. Në këtë kontekst, faktorët e sipërpërmendur në lidhje me financimin e terrorizmit, janë gjithashtu të rëndësishëm për financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë.

Çfarë janë sanksionet financiare

Në nivel ndërkombëtar sanksionet përdoren si një mjet i politikës së jashtme, si pjesë e një strategjie më të gjerë politike dhe diplomatike për të arritur një rezultat të caktuar. Ato zakonisht pranohen dhe koordinohen

në nivel ndërkombëtar nga KSKB apo organizma të tjerë (p.sh. Bashkimi Evropian) dhe mund të përfshijnë kufizime në udhëtime, furnizimin me armë, transaksionet financiare dhe tregtare ndaj individëve dhe subjekteve, etj.

Qëllimi kryesor i sanksioneve, të ndërmarra në përputhje me kapitullin VII të Kartës së OKB, është zbatimi i vendimeve të KSKB, për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Në këtë kuadër sanksionet mund të ndahen në tre kategori

- a) financimi i terrorizmit;
- b) financimi i përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë;
- c) sanksione të përgjithshme ndaj vendeve specifike (konfliktet e brendshme);

Sanksionet financiare marrin forma të ndryshme dhe zbatohen në përgjigje të një situatë të caktuar. Llojet më të zakonshme të sanksioneve financiare të përdorura në vitet e fundit janë:

1. Bllokimi i pasurive - të cilat zakonisht aplikohen tek individët dhe subjektet e shpallura si terroristë apo financues të terrorizmit apo ata të përfshirë në përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, duke kufizuar qasjen e tyre në fonde dhe pasuri të tjera apo aftësinë për të përdorur burimet e tyre ekonomike.

Në rastet e bllokimit të pasurive, individëve dhe subjekteve ju ndalohe:

- a) Veprimet apo marrëdhëniet me fondet ose burimet ekonomike, që i përkasin ose zotërohen, mbahen ose kontrollohen nga persona të shpallur;
- b) Të sigurojnë fonde ose burime ekonomike, në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë, për persona të shpallur;
- c) Të angazhohen në veprime që, drejtpërdrejt ose tërthorazi, anashkalojnë kufizimet apo ndalimet e parashikuara në këto sanksione;

Fondet, burimet ekonomike dhe pasuritë e personave të shpallur, kërkohet që të ngrihen në mënyrë të menjëhershme nga personi apo subjekti që i ka në administrim apo kontrollon përdorimin e tyre.

2. Kufizimet në shërbimet dhe veprimet që ofrohen nga tregjet dhe institucionet financiare - këto kufizime mund të zbatohen ndaj grupeve të caktuara ose për sektorë të tërë të sistemit ekonomiko-financiar të një vendi. Këto kufizime përfshijnë individët dhe subjektet e shpallura dhe janë në formën e:

- a) Ndalimit të investimeve;
- b) Kufizimeve në tregjet e kapitalit;
- c) Udhëzimeve për të ndërprerë marrëdhëniet dhe aktivitetet bankare;
- ç) Kërkesave për të kërkuar autorizimin paraprak për marrëdhëniet e biznesit ose pagesat;
- d) Kufizimeve në sigurimin e shërbimeve financiare, të sigurimit, ndërmjetësimit apo veprimtarisë këshillimore;

3. Udhëzimet për të ndërprerë çdo marrëdhënie biznesi - të një lloji të specifikuar me një person, grup, territor apo vend të caktuar.

Si vendosen sanksionet

OKB vendos mbi sanksionet financiare dhe u kërkon shteteve anëtare t'i zbatojnë ato përmes rezolutave të miratuara nga KSKB³.

Sanksionet, përfshirë dhe ato financiare, vendosen në përgjithësi ndaj qeverisë së një vendi, individëve apo subjekteve të shpallur si terrorist apo financues të terrorizmit, apo ata të përfshirë në përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë ose financimin e tyre. Masat vendosen mbi individët apo subjektet e shpallura, me qëllim që t'ju ndalojë atyre qasjen në burimet financiare dhe ekonomike, të cilat ata mund t'i përdorin, për financimin e terrorizmit apo përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë.

REKOMANDIMET NDËRKOMBËTARE TË FATF

FATF është një organ ndërqeveritar, i themeluar në vitin 1989 dhe ka si objektiv hartimin e standardeve dhe nxitjen e zbatimit efektiv të masave ligjore, rregullatore dhe operacionale për luftimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, apo kërcënimeve të tjera të lidhura me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar.

FATF në funksionin e saj të hartimit të politikave, punon për të siguruar vullnetin e nevojshëm politik, për të ndërmarrë reforma kombëtare legjislative dhe rregullatore në fushat e sipërpërmendura.

Në këtë kuadër, FATF ka hartuar një sërë rekomandimesh që njihen si standarde ndërkombëtare për luftën kundër pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, të cilat përbëjnë bazën për një reagim të bashkërenduar dhe të harmonizuar ndaj këtyre kërcënimeve dhe ruajtjes së integritetit të sistemit financiar. Për herë të parë këto rekomandime janë publikuar në vitin 1990, dhe kanë qenë subjekt rishikimi të konsiderueshëm në vitet 1996, 2001, 2003 dhe më së fundi në vitin 2012 (me disa amendime të mëtejshme të bëra që nga 2012).

FATF monitoron ecurinë e vendeve anëtare në zbatimin e rekomandimeve, shqyrton tipologjitë e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe masat parandaluese që duhet të ndërmerren. Në bashkëpunim me aktorë të tjerë ndërkombëtarë, FATF punon për të identifikuar dobësitë në nivel kombëtar me qëllim të mbrojtjes së sistemit financiar ndërkombëtar nga abuzimet.

Në vijim paraqiten dy nga rekomandimet e FATF, të cilat përcaktojnë detyrimet përkatëse të vendeve në lidhje me sanksionet ndërkombëtare.

Rekomandimi 6

Sanksionet financiare të lidhura me terrorizmin dhe financimin e tij

Vendet duhet të zbatojnë regjimet e sanksioneve financiare specifike, për të siguruar përputhshmëri me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB, në lidhje me parandalimin dhe goditjen e terrorizmit dhe

³ Në faqen e internetit të OKB-së jepet një informacion më i hollësishëm në lidhje me sanksionet financiare (<https://www.un.org/sc/suborg/en/sanctions/information>)

financimin e tij. Këto rezoluta kërkojnë nga vendet anëtare, të ngrijnë pa vonesë fondet ose pasuritë e tjera dhe për të siguruar që asnjë fond ose pasuri tjetër të mos vihet në dispozicion, drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, për çdo person ose subjekt:

- a) të shpallur nga Këshilli i Sigurimit në bazë të Kapitullit VII të Kartës së OKB dhe në përputhje me rezolutën 1267 (1999) dhe pasardhësin e saj Rezolucione; ose
- b) të shpallur nga ai vend sipas rezolutës 1373 (2001);

Duhet të theksohet se asnjë nga detyrimet në Rekomandimin 6, nuk ka për qëllim të zëvendësojë masa apo detyrime të tjera ekzistuese në kontekstin e një hetimi kriminal, civil ose administrativ.

Qëllimi kryesor i këtij rekomandimi është ndërmarrja e masave të nevojshme dhe me një natyrë unike në kontekstin e ndalimit të qarkullimit dhe përdorimit të fondeve apo pasurive të tjera nga grupet terroriste. Në zbatimin e këtij rekomandimi kërkohet gjithashtu t'i kushtohet vëmëndje respektimit të të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe të njihen të drejtat e palëve të treta.

Rekomandimi 6 është i zbatueshëm për rezolutën 1267 të KSKB dhe Rezoluten 1373.

Rekomandimi 7

Sanksionet financiare të lidhura me financimin e armëve të shkatërrimit në masë

Vendet duhet të zbatojnë sanksione financiare specifike për të siguruar përputhshmëri me rezolutat e Këshillit të Sigurimit në lidhje me parandalimin dhe goditjen e armëve të shkatërrimit në masë dhe financimin e tyre. Këto rezoluta kërkojnë që vendet të ngrijnë pa vonesë fondet ose pasuritë e tjera dhe për të siguruar që ato nuk vihen në dispozicion, të drejtpërdrejt ose të tërthortë të personave apo subjekteve të shpallura nga Këshilli i Sigurimit i OKB.

Duhet të theksohet se kërkesat e rekomandimit 7, nuk kanë për qëllim të zëvendësojnë masat ose detyrimet e ndërmarra në kontekstin e një hetimi kriminal, civil apo administrativ. Qëllimi i këtij rekomandimi është parandalimi dhe masat e nevojshme dhe unike në kontekstin e ndalimit të qarkullimit të fondeve apo pasurive të tjera që mund të përdoren për prodhimin apo financimin e armëve të shkatërrimit në masë, në përputhje me kërkesat e Këshillit të Sigurimit.

Shpalljet bëhen nga Këshilli i Sigurimit, nëpërmjet publikimit të shtojcave të rezolutave përkatëse, ose nga Komiteti i Posaçëm i Këshillit të Sigurimit, i themeluar në bazë të këtyre rezolutave.

Rekomandimi 7 është i zbatueshëm për të gjitha rezolutat aktuale të Këshillit të Sigurimit, që aplikojnë sanksione financiare specifike për financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, si dhe çdo rezolutë pasardhëse⁴.

⁴ Rezolutat 1718 (2006), 1737 (2006), 1747 (2007), 1803 (2008), 1874 (2009) dhe 1929 (2010).

NGRIRJA DHE NDALIMI I PËRDORIMIT TË FONDEVE DHE PASURIVE

Procesi i shpalljes nga KSKB apo vendet anëtare të OKB, përqëndrohet tek ata individë dhe subjekte që përfaqësojnë elementët kyç, të një rrjeti mbështetës të terroristëve, në mënyrë që të sigurohet efekti maksimal në parandalimin dhe goditjen e akteve terroriste. Një qasje e ngjashme është marrë për shpalljet në lidhje me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë.

Rëndësia e një regjimi efektiv bllokimi

Krijimi i një regjimi efektiv të bllokimit të fondeve dhe pasurive të personave apo subjekteve të përfshira në financimin e terrorizmit apo armëve të shkatërrimit në masë, është i një rëndësie të veçantë dhe duhet të synojë të shkojë përtej bllokimit dhe sekuestrimit të fondeve dhe pasurive të tjera. Regjimet efektive të bllokimit shërbejnë si masë parandaluese nëpërmjet:

- a) Pengimit të personave ose subjekteve të pa-shpallura, të cilët mund të jenë të gatshëm të financojnë veprimtari terroriste ose përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë;
- b) Ekspozimit të “gjurmëve të parave” të financimit të terrorizmit apo financimit të armëve të shkatërrimit në masë, që mund të japin të dhëna për celula terroriste apo financues të tyre, të panjohur nga organet kompetente;
- c) Shpërbërjes së rrjeteve të financimit të terrorizmit apo rrjeteve në ndihme të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, duke nxitur personat ose subjektet e shpallura të distancohen vetë nga këto aktivitete dhe të heqin dorë nga pjesëmarrja në grupe të tilla;
- ç) Ndërprerjes së flukseve monetare të terroristëve apo lëvizjes së fondeve ose pasurive të lidhura me terroristët, apo ata të lidhur me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë;

Mangësitë në bllokimin e shpejtë dhe efektiv të fondeve dhe pasurive të personave të shpallur apo në proces shpallje, kanë një efekt negativ në përpjekjet që ndërmarrin vendet dhe komuniteti ndërkombëtar për të luftuar financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë.

Natyra globale e këtyre aktiviteteve, sidomos rrjeteve të financimit të terrorizmit dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, si dhe nevoja e urgjencës në përgjigjen ndaj këtyre kërcënimeve, gjithashtu diktojnë nevojën e bashkëpunimit ndërinstitucional si dhe komunikimin mes sektorit publik dhe atij privat, pasi shpërndarja e shpejtë dhe efikase e informacioneve mbi financimin e terrorizmit apo përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, për të gjithë ata që mund të ndihmojnë në identifikimin, pengimin dhe shpërbërjen e rrjeteve të financimit, është një faktor kryesor për të siguruar një bllokim efektiv të fondeve apo pasurive të tjera.

Përmes këtij procesi komunikimi dhe bashkëpunimi synohet:

- a) të sigurohen të gjitha të dhënat e mundshme, për të identifikuar me saktësi personin e shpallur (p.sh. datëlindja, adresa, shtetësia ose numri i pasaportës të individëve; vendi i krijimit të shoqërisë, për personat juridik etj.);
- b) të shqyrtohet dhe bashkërendohet, sipas rastit, çdo shpallje në përputhje me alternativat dhe veprimet që mund të ndërmerren kundrejt terroristëve, organizatave terroriste dhe atyre të përfshirë në financimin përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe personave të lidhur me ta;
- c) përcaktimin e një procesi për sektorin privat (veçanërisht institucionet financiare dhe profesionet e lira) për të informuar organet kompetente në lidhje me fondet apo pasuritë e bllokuara, emrat e personave, llogaritë dhe shumat;

Blokimi sipas standarteve ndërkombëtare

Rekomandimi 6, përmban detyrimin për ngrirjen e menjëhershme të fondeve dhe pasurive të tjera të personave dhe subjekteve të shpallura. Në kuadrin e sanksioneve të rezolutës 1267 (sanksione ndaj Al-Kaidës, ISIS dhe bashkëpunëtorëve si dhe Talibanëve), ky bllokim nënkupton që ai të realizohet pa vonesë dhe në mënyrë ideale brenda disa orësh nga shpallja prej KSKB ose sanksionet e komitetit të tij përkatës (Komiteti 1267, ose Komiteti 1988).

Në funksion të zbatimit të rezolutës 1373(2001), bllokimi i menjëhershëm dhe pa vonesë, nënkupton kohën gjatë së cilës sigurohen shkaqet ose bazat e arsyeshme për të pasur, dyshuar ose besuar që një person apo subjekt është terrorist, financon terrorizmin ose është organizatë terroriste.¹⁷

Rekomandimi 7, përmban një detyrim për ngrirjen e menjëhershme të fondeve dhe pasurive të tjera të personave dhe subjekteve të shpallur, në kuadrin e Rezolutave 1718 dhe 1737.

Në të gjitha rastet, menjëherë dhe pa vonesë duhet të interpretohet në kontekstin e nevojës vendimtare, për të parandaluar procesin e lëvizjes apo transferimit të fondeve apo tjetërsimit të pasurive të personave të shpallur.

Ngrirja sipas legjislacionit shqiptar

Shqipëria ka një legjislacion të plotë në funksion të zbatimit të masave kufizuese, i cili është në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare. Ky legjislacioni përfshin një ligj specifik për pasuritë që lidhen me terrorizmin, ligji nr.157, datë 10.10.2013 “*Për Masat kundër Financimit të Terrorizmit*” (LKMFT) dhe një ligj të përgjithshëm për zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, përfshirë ato që lidhen me pasuritë që lidhen me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, ligji nr. 72, datë 17.10.2019 “*Për Masat Ndërkombëtare kufizuese në Republikën e Shqipërisë*” (Ligji i masave kufizuese). Shkeljet sipas këtyre ligjeve, janë subjekt i masave ndëshkuese, siç përcaktohet në nenin 27 të ligjit nr.157 dhe nenin 19 të ligjit nr.72, në të cilat përfshihe masa administrative deri në vlerën 10 Million lek.

Procesi i bllokimit të fondeve dhe pasurive të terroristëve apo personave të lidhur me terrorizmin, sipas kuadrin 1267 të KSKB dhe Rezolutës 1373, është përcaktuar në LKMFT si dhe akteve nënligjore të në zbatim të tij.

LKMFT, ka për qëllim parandalimin dhe goditjen e veprimtarive të terroristëve dhe të atyre që mbështesin dhe financojnë terrorizmin, apo të atyre, për të cilët ka dyshime të bazuara që kanë kryer, po kryejnë ose kanë qëllim të kryejnë veprimtari të tilla, nëpërmjet bllokimit, sekuestrimit të fondeve e pasurive të tyre, në zbatim të rezolutave përkatëse të Këshillit të Sigurimit, akteve të organizatave të tjera ndërkombëtare apo marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 22 “*Sekuestrimi i fondeve dhe pasurive të tjera*” i LKMFT, përcakton modalitetet e sekuestrimit të fondeve dhe pasurive. Kërkesa për ngrirjen e pasurive bazohet në një urdhër sekuestrimi të lëshuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave për personat e shpallur sipas kërkesave të rezolutave të KSKB. Urdhri i Ministrisë ka efekte të menjëhershme dhe i komunikohet personit të shpallur në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative. Urdhëri i dërgohet njëkohësisht Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe

institucioneve, subjekteve dhe organeve përgjegjëse, kur identifikohen fonde dhe pasurive të tjera, të cilët marrin masa për ekzekutimin e menjëhershëm të tij.

Sekuestrimi i fondeve dhe pasurive vlen për të gjitha fondet dhe pronat e tjera, mbi të cilat personi i shpallur ushtron të drejtat e pronësisë, kontrollit ose interesave të tjera, pavarësisht se kush posedon ose përdor fondet ose pronat, si dhe për secilin fond dhe pronë që gjendet në posedim ose i mbajtur nga personat e shpallur. Kjo përfshin fonde dhe pasuri:

- a) në të cilin personi i shpallur ushtron të drejtat e kontrollit faktik;
- b) në pronësi ose të kontrolluar nga personi i shpallur, pa kufizuar masat mbi fondet dhe pasuritë e tjera që mund të shoqërohen me një akt specifik terrorist, komplot ose kërcënim;
- c) që janë të kontrolluar individualisht ose së bashku, drejtpërdrejt ose indirekt, nga personat e përcaktuar;
- ç) që rrjedhin ose janë gjeneruar nga fondet ose pasuritë në pronësi ose të kontrolluara, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte, nga personat e shpallur;
- d) të personave që veprojnë për llogari ose nën drejtimin e personave të shpallur.

Ministri përgjegjës për financat bazuar në nenin 16 “*Bllokimi i përkohshëm*” të LKMFT, mund të urdhërojë përpara nxjerrjes së vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, bllokimin e fondeve dhe pasurive të tjera për 45 ditë, nëse kjo është mënyra e vetme për të parandaluar shmangien e zbatimit të masave të këtij ligji.

Neni 10/1 “*Ngrirja e përkohshme*” i LKMFT, kërkon prej subjekteve raportuese (të ligjit nr.9917, datë 19.05.2008 “*Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*”) dhe çdo subjekt ose individ tjetër në Republikën e Shqipërisë për të ngrirë përkohësisht fonde ose pasuri të tjera të subjekteve ose individëve të shpallur nga KSKB ose ndonjë organizatë tjetër ndërkombëtare menjëherë pas njoftimit të shpalljes. Vendimet e KSKB ose organizatave të tjera ju njoftohen zyrtarisht subjekteve raportuese, publikohen gjithashtu në faqen zyrtare të DPPPP (www.fiu.gov.al) dhe në modulën e raportimit⁵. Në bazë të nenit 10/1, ndalohet që të jepet njoftimi paraprak për ngrirje të përkohshme, për çdo person të shpallur ose person tjetër të interesuar ose të prekur. Vendimet e KSKB konsiderohen të njoftuara zyrtarisht prej momentit kur komiteti përkatës i KSKB, ka publikuar njoftimin në faqen zyrtare të internetit⁶.

Ngrirja e përkohshme sipas nenit 10/1, ndalon transferimin, shndërrimin, disponimin ose lëvizjen e ndonjë fondi ose prone tjetër në pronësi ose të kontrolluar nga një person ose subjekt i shpallur dhe përfshin fondet ose pasuritë e tjera, burimet ekonomike, financiare ose shërbime të tjera. Ndalohet vënia e tyre në dispozicion direkt ose indirekt për personat ose subjektet e shpallura, subjektet në pronësi ose kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë prej tyre dhe persona ose subjekte që veprojnë në emër të tyre ose nën orientimin e personave ose subjekteve të shpallura. Ngrirja e përkohshme sipas Nenit 10/1, zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga subjektet e ligjit apo çdo person, menjëherë pas publikimit të vendimit të shpalljes nga KSKB ose ndonjë organizatë tjetër, pa pasur nevojë për një urdhër bllokimi, ose një vendim përkatës të Këshillit të Ministrave sipas nenit 18 dhe mbetet në fuqi derisa të jetë nxjerrë një urdhër bllokimi sipas nenit 16. Shpalljet nga KSKB ose ndonjë organizatë tjetër, kanë efekt të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm në Shqipëri.

⁵ www.fint.gov.al. Faqe e kufizuar në të cilën kanë akses subjektet e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave

⁶ <https://www.un.org/securitycouncil/sanctions/un-sc-consolidated-list>

Përhapja e armëve të shkatërrimit në masë

Procesi i ngrirjes së fondeve dhe pasurive të atyre të caktuar në kuadrin e Rezolutës 1718 të KSKB dhe kuadrin 1737 të KSKB, është përcaktuar në ligjin e Masave Kufizuese dhe akteve nënligjore të nxjerra për zbatimin e tij. Qëllimi i ligjit për Masat Kufizuese, është që të vendosë dhe të zbatojë masat kufizuese ndërkombëtare që shërbejnë për ruajtjen e paqes dhe sigurisë, parandalimin e konflikteve ndërkombëtare, mbështetjen dhe forcimin e demokracisë, sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut, si dhe arritjen e objektivave të tjera të përbashkëta të sigurisë në përputhje me rezolutat përkatëse të KSKB, akteve të organizatave të tjera ndërkombëtare, ose traktateve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë. Kjo përfshin masat e sipërpërmendura ndërkombëtare për të luftuar financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit.

Në nenin 6 të ligjit për Masat Kufizuese, përcaktohen modalitetet e sekuestrimit të fondeve dhe pasurive të tjera. Këshilli i Ministrave miraton aplikimin e masave kufizuese ndërkombëtare (të cilat përfshijnë shpalljet në kuadrin e Rezolutave 1718 dhe 1737 të KSKB) me rekomandimin e Ministrit përgjegjës për Punët e Jashtme.

Ngrirja e fondeve sipas ligjit të Masave Kufizuese, nënkupton ndalimin e transferimit, modifikimit, posedimit ose zhvendosjes së:

- a) çdo fondi dhe pasurie që zotërohet ose kontrollohet nga personi ose subjekti i shpallur dhe jo vetëm ata që mund të lidhen me një akt, plan ose kërcënim të caktuar të financimit të prodhimit të armëve të shkatërrimit në masë;
- b) çfarëdo fondi ose pasurive të tjera në pronësi të plotë, të bashkuara, të kontrolluara direkt ose indirekt nga subjektet ose personat e shpallur;
- c) fondet ose pasuritë që rrjedhin, krijohen nga fondet ose aktivet në pronësi ose të kontrolluara drejtpërdrejt ose indirekt nga subjektet ose personat e caktuar;
- ç) fondet dhe pasuritë e personave ose subjekteve që veprojnë në emër ose nën drejtimin e subjekteve ose personave të shpallur;

Ekzistojnë gjithashtu dispozita specifike në nenin 12 “*Bllokimi i asetëve dhe i fondeve*” të ligjit për Masat Kufizuese në lidhje me llogaritë e ngrira në kuadër të Rezolutave 1718 dhe 1737 të KSKB. Këto lejojnë shtimin e interesit të përllogaritur në ato llogari dhe gjithashtu pagesa në bazë të kontratave të mëparshme ose detyrime të tjera, me kusht që këto interesa, të ardhura ose pagesa të jenë të ngrira. Për më tepër, për pasuritë e ngrira në kuadër të Rezolutës 1737 të KSKB, një person ose subjekt i shpallur mund të bëjë pagesa që bazohen në një kontratë paraprake, me kusht që kontrata të mos ketë lidhje me asgjë të ndaluar në kuadrin e Rezolutës 1737, pagesa nuk është duke ju bërë drejtpërdrejt ose tërthorazi një personi ose subjekti të shpallur, dhe njoftimi i është dhënë komitetit përkatës të KSKB.

Pezullimi i përkohshëm i veprimtarive që lidhen me një person të shpallur, kërkohet sipas nenit 8 të Ligjit për Masat Kufizuese. Kjo nënkupton ndalimin e çdo transaksioni, shërbimi financiar ose shërbime të tjera të ndërlydhura, pjesëmarrje në transferimin, transformimin, tjetërsimin ose lëvizjen e fondeve ose pasurive të tjera që përfshijnë prona të luajtshme ose të paluajtshme, duke iu nënshtruar kushteve dhe periudhës së vlefshmërisë, në bazë të veprimeve të ndërmarra nga institucionet kompetente.

Bazuar në njoftimin nga Ministrit përgjegjës për Punët e Jashtme, për çdo ndryshim në listën e personave të shpallur, të gjithë personat juridikë ose fizikë në Shqipëri janë të detyruar që menjëherë të pezullojnë çdo

veprim, ndërmjetësim, transaksion, transferim, shërbime financiare ose shërbime të tjera të lidhura, fonde dhe mjete të tjera, pa pasur nevojë për akte nënligjore shtesë. Kjo vlen për çdo rast kur subjekti i shpallur ushtron të drejtat e pronësisë ose kontrollit, me autorizim, ose të drejta dhe interesa të tjera, pavarësisht se kush zotëron ose posedon fonde ose pasuri të tjera, si dhe për çdo fond ose pasuri që mbahet ose të zotërohet nga personi i shpallur. Fondet dhe pasuritë e pezulluara përkohësisht, mbeten në pronësi të personave të cilët kanë të drejta pronësie mbi to, në momentin e vendosjes së masës së pezullimit të përkohshëm.

Pezullimi i përkohshëm është i drejtpërdrejtë, i menjëhershëm dhe është i vlefshëm për jo më shumë se 45 ditë pune, duke filluar nga dita e parë pas nxjerrjes së tij. Bazuar në pikën 3 të nenit 8 “*Bllokimi i përkohshëm*” i ligjit për Masat Kufizuese, ndalohet njoftimi paraprak i personave të shpallur, të interesuar ose të prekur, në lidhje me masat për bllokimin e përkohshëm.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, shpalljet që lidhen me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë nga KSKB ose ndonjë organizatë tjetër kanë efekt të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm në Shqipëri.

Detyrimet e raportimit

Sipas nenit 10 “*Detyrimi për raportim*” të LKMFT, ekzistojnë dy detyrime për raportim. Së pari, pika 1 e këtij neni, vlen për subjektet e ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të cilët duhet të raportojnë pranë DPPPP informacione ose dyshime për veprime financiare, transaksione, fonde ose akte të tjera, të kryera apo që tentohet të kryhen, që kanë për qëllim kryerjen ose financimin e akteve terroriste, pavarësisht nga vlera e tyre.

Së dyti, detyrimi sipas pikës 2, të nenit 10 vlen për çdo person që ka dijeni për veprimet financiare, transaksionet, fondet ose aktet e tjera të kryera ose që janë përpjekur të kryhen, me qëllim kryerjen ose financimin e akteve terroriste, për të cilët kanë detyrimin për të njoftuar menjëherë DPPPP.

Përveç detyrimeve të raportimit sipas nenit 10, të dhënat e plota për rastet e ngrirjes së përkohshme, sipas nenit 10/1 “*Ngrirja e përkohshme*”, përfshirë transaksionet në tentativë, duhet t’i komunikohen menjëherë DPPPP, e cila jep udhëzimet e nevojshme.

Në çdo rast, raportimi duhet të kryhet menjëherë dhe pa njoftim paraprak dhe përfshirje të personave të dyshuar ose të prekur. Raporti në fjalë duhet të përmbajë të dhëna për identifikimin e fondeve dhe pasurive të tjera, të dhëna në lidhje me pronësinë dhe interesat e tjera të lidhura, si dhe shpjegime për motivet që mbështesin të dhënat e arsyeshme. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet detyrimi për raportimin e transaksioneve në tentativë, ku përfshihen situatat kur një transaksion nuk kryhet, qoftë sepse subjekti raportues ka refuzuar të vendosë marrëdhënien e biznesit, klienti vendos të mos e realizojë ose për ndonjë arsye tjetër.

Procesi i ankimit

Respektimi i të drejtave të njeriut është pjesë përbërëse e çdo sistemi të bllokimit të fondeve dhe pasurive të personave të shpallur, përfshirë këtu dhe personat e lidhur me ta.

Në këtë kuadër, si LKMFT ashtu edhe ligji i Masave Kufizuese kanë dispozita apelimi.

Neni 17 i LKMFT, “Ankimi kundër bllokimit të përkohshëm” dhe Neni 19 i tij, “Ankimi kundër vendimit të Këshillit të Ministrave”, kanë parashikuar një mekanizëm të qartë të ankimit të urdhrin të bllokimit të përkohshëm të Ministrit të Financave si dhe listimit të personit të shpallur, me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në rastin e ankimit kundër bllokimit të përkohshëm personi i interesuar ka detyrimin që të provojë përpara gjykatës se:

- a) ka një të drejtë të ligjshme në fondet dhe pasuritë e tjera të personit, të përcaktuara në urdhrin e Ministrit të Financave;
- b) ka burime të justifikuara ligjërisht për të drejtat dhe interesat e tij në fondet dhe pasuritë e tjera; fondet dhe pasuritë e tjera, objekt gjykimi, nuk kanë lidhje me terroristë, persona që financojnë terrorizmin ose persona të tjerë të lidhur me ta;

Në rastet e ankesave ndaj vendimeve të Këshillit të Ministrave, kjo vlen për vendimet e marra për të zbatuar të dy kornizat e Rezolutave 1267 të KSKB dhe Rezolutës 1373 (d.m.th. shpalljet e brendshme). Në rastin e ankesave që kanë të bëjnë me shpalljet sipas kuadrit të Rezolutës 1267 të KSKB, ankesa mund të bëhet vetëm me arsyetimin se ankuesi është identifikuar gabimisht si personi i shpallur.

Ekziston gjithashtu një e drejtë e ankimit kundër urdhrin të sekuestrimit sipas nenit 24, të ligjit që zbatohet në rastet kur personat e shpallur dhe personat e interesuar pretendojnë se janë në mirëbesim.

Në të dy rastet, ankimi bëhet në gjykatën kompetente, sipas afateve dhe procedurave të gjykimeve administrative.

Neni 18 i ligjit për Masat Kufizuese gjithashtu përmban dispozita që lejojnë që ankesa të paraqitet nga një subjekt që pretendon të jetë identifikuar gabimisht si subjekt i shpallur.

Procesi i heqjes nga lista

Neni 25 i LKMFT ,përcakton mënyrën se si Këshilli i Ministrave të ndryshojë apo revokojë një vendim të mëparshëm. Këshilli i Ministrave merr vendim në lidhje me ndryshimin ose revokimin e vendimit në listën e personave të shpallur, brenda 15 ditëve nga paraqitja e propozimit të ministrit përgjegjës për financat, ministrit përgjegjës për punët e jashtme, kërkesën e personit të shpallur ose personit të prekur gabimisht. Revokimin apo ndryshimi i një vendim të mëparshëm, bëhet në një nga rastet e mëposhtme:

- a) Ka një vendim të mëvonshëm të strukturave të Këshillit të Sigurimit, sipas pikës 1 të nenit 5 të ligjit;
- b) Për shkak të një detyrimi që i kërkohet ose i lind Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 25 të Kartës së OKB;
- c) Vendimi përkatës i organizatave të tjera ndërkombëtare, të Bashkimit Evropian ose sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë;
- ç) Vendimi i heqjes nga lista të personit nga vendi që ka kërkuar shpalljen;
- d) Ka një vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente, të marrë pas ankimit të personit të shpallur, sipas pikave 1 dhe 3 të nenit 19 të këtij ligji;
- e) Kanë ndryshuar rrethanat, faktet dhe arsyet, për të cilat është bërë shpallja, sipas nenin 15 të këtij ligji;

Në lidhje me financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, vendimet e Këshillit të Ministrave për zbatimin e përcaktimeve të organeve ndërkombëtare mund të revokohen në bazë të neneve 6 dhe 7 të ligjit të Masave Kufizuese.

Sidoqoftë, është e rëndësishme për të qenë të vetëdijshëm se Këshilli i Ministrave, nuk mund të revokojë në mënyrë të njëanshme listat e nxjerra nga organet ndërkombëtare. Çdo person i cili dëshiron të hiqet nga listat e KSKB ose Bashkimit Evropian, mund t'i kontaktojë ata në mënyrë direkte:

- Kombet e Bashkuara - çdo person që dëshiron të hiqet ose fshihet nga kuadri i Rezolutës 1267, 1718 dhe 1737 të KSKB ose listave të tjera të sanksioneve të KB, duhet të aksesojnë qendrën për heqjen nga lista në faqen e internetit të Kombeve të Bashkuara⁷.
- Bashkimi Evropian - kërkesat për t'u hequr nga lista në bazë të Rregulloreve të BE-së mund të dërgohen në adresën relex-sanctions@ec.europa.eu.

Qasja në fondet dhe pasuritë e tjera

Në rastet që lidhen me terrorizmin, neni 23 i LKMFT, lejon ministrin përgjegjës për financat, të autorizojë pagesa nga pasuri dhe prona të tjera të sekuestruara që do të përdoren për nevoja mjekësore, familjare dhe personale të personit të shpallur, për pagimin e detyrimeve shtetërore ose të lidhura me punën dhe sigurimet e detyrueshme. Refuzimi për autorizimin e një pagese nga Ministri, mund të apelohe brenda 5 ditëve nga koha e refuzimit.

Bazuar në nenin 23, të LKMFT, Ministri i Financave ka miratuar Udhëzimin nr.1 dt.16.01.2014 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për shpenzimet e lejueshme mbi fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara të personave të shpallur”, i cili pasqyron të drejtat dhe shpenzimet e lejuara, që personat e shpallur kanë për fondet dhe pasuritë e sekuestruara.

Kategorizimi i shpenzimeve të lejuara, në themelore dhe të jashtëzakonshme është bërë mbi bazën e Rezolutës 1452, të Këshillit të Sigurimit dhe synon që të krijojë kushtet për mbulimin e shpenzimeve për ushqim, barna dhe trajtime mjekësore, pagesën e qerasë apo hipotekës si dhe detyrime të tjera që shkaktohen nga forca madhore.

Neni 4 i këtij udhëzimi, përcakton hapat që kërkuesi duhet t'i paraqesë Ministrit të Financave dhe Ekonomisë të shoqëruar me pretendimet mbi fondet e sekuestruara si dhe dokumentacionin justifikues për sa i përket vlerës dhe mënyrës së përdorimit të fondeve të kërkuara. Shqyrtimi i kërkesës bëhet në përputhje me nenet 5 dhe 6 të këtij udhëzimi.

Në rastet që lidhen me financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, qasja në fonde dhe pasuri të tjera parashikohet në nenin 13 “Lejimi i përdorimit të asetëve të bllokuara” të ligjit të Masave

⁷ https://www.un.org/securitycouncil/sanctions/1267/aq_sanctions_list/procedures-for-delisting

<https://www.un.org/securitycouncil/sanctions/1718/materials/procedures-delisting>

Kufizuese. Qasja mund të jepet nga një gjykatë kompetente, me kusht që të vërtetohet se pasuritë janë të domosdoshme për:

- a) mbulimin e kostove themelore të jetesës, hipotekës së qirasë apo shtëpisë, barnave ose trajtime mjekësore, taksat dhe sigurimet ose kostot e shërbimeve publike;
- b) pagesa vetëm taksa për mirëmbajtjen e rregullt të pasurive të ngrira;
- c) për shpenzime të jashtëzakonshme, siç janë shpenzimet që lidhen me lindjen e fëmijëve, vdekjen në familje ose situata të ngjashme;

Fondet dhe pasuritë që janë subjekt i bllokimit

Detyrimi i shprehur në rezolutën 1373 (2001) në kuadrin e Rezolutës 1267, 1718, 1737 të KSKB, dhe kërkesave të Rekomandimit 6 dhe 7 janë për të ngrirë fondet ose pasuritë e tjera. Këto janë përkufizuar në Fjalorin e Rekomandimeve të FATF dhe zbatohen për çdo pasuri, duke përfshirë por pa u kufizuar në, pasuritë financiare, burimet ekonomike, pronë e çdo lloji, të luajtshme apo të paluajtshme, pavarësisht mënyrës së sigurimit dhe dokumentet ose instrumentet ligjore të çfarëdo forme (elektronike ose dixhitale), evidentimi i titujve, ose interesin në këto fonde, kreditë bankare, çeqet e udhëtarëve, çeqet bankare, urdhërpagesat, aksionet, siguracionet, obligacionet, apo letrat e kreditit, dhe çfarëdo interesi, pjesë nga fitimi i kompanive.

Neni 3.3 i ligjit LKMFT përkufizon në përputhje me rekomandimet e FATF “Fonde dhe pasuri të tjera” janë pasuritë financiare, depozitat monetare dhe pronat e çdo lloji, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht nga mënyra e fitimit, si dhe dokumentet ligjore apo instrumentet e çdo lloji, përfshirë ato elektronike ose digjitale, që provojnë pronësinë ose interesat në këto fonde dhe pasuri të tjera. Këtu përfshihen, por pa u kufizuar vetëm në to, kreditë bankare, çeqet bankare ose të udhëtarëve, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, bonot, pagesat, letërkreditet dhe çfarëdo interesi, dividendi ose të ardhurat e tjera, si dhe vlerat që grumbullohen a gjenerohen nga fonde ose pasuri të tjera.

dhe në mënyrë të ngjashme përkufizohen dhe në nenet 4.1 dhe 4.13 të ligjit të Masave Kufizuese.

4.1. “Asete” janë fondet dhe të gjitha elementet e tjera të pasurisë së shteteve, organizatave ndërkombëtare, personave fizikë e juridikë dhe entiteteve të tjera, ndaj të cilave zbatohen masat shtrënguese, që përfshijnë: likuiditetet, çeqet, pretendimet financiare, kambialet, paraja elektronike dhe mjete të tjera pagesash; instrumente financiare, të referuara në ligjin që rregullon tregjet financiare, përfshirë aksionet, obligacionet, garancitë dhe instrumente të tjera financiare, që provojnë të drejtat mbi fonde ose burime të tjera financiare, si dhe çdo objekt apo e drejtë ekonomike:

- a) e kontrolluar, e zotëruar tërësisht, direkt apo indirekt nga entitetet e lartpërmendura;*
- b) e rrjedhur dhe e prodhuar nga pasuritë e zotëruara apo të kontrolluara direkt apo indirekt nga entitetet e lartpërmendura;*
- c) e personave apo enteve që veprojnë për llogari apo nën drejtimin e entiteteve të lartpërmendura.*

4.13. “Fond” janë asete të çdo lloji, qofshin këto të përfshira ose të papërfshira, të prekshme ose të paprekshme, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht se si janë fituar, si dhe dokumente apo instrumente ligjore të çdo forme, duke përfshirë ato elektronike apo digjitale, titujt tregues apo interesat në këto asete.

RAPORTIMI I TË DHËNAVE

Cilësia dhe dobishmëria e të dhënave

Duke pasur parasysh shkallën e lartë të transaksioneve të mbuluara nga bllokimi i fondeve apo pasurive si dhe numrin e konsiderueshëm të personave dhe subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, është e rëndësishme që sektori privat të sigurojë një nivel të lartë përputhshmërie me detyrimet ligjore në fuqi.

Një ndër problemet kryesore që haset në këtë drejtim, është identifikimi i një personi ose subjekti në listën e sanksioneve. Gjeneralitetet komplekse të personave të shpallur, shpesh herë rrisin barrën administrative të përputhshmërisë së subjekteve private dhe kanë një efekt të ngjashëm në zbatimin e ligjit. Në këtë kuadër rritja e mëtejshme e kapaciteteve parandaluese të subjekteve, nxjerr në pah dhe rolin e rëndësishëm të sektorit privat, në funksion të zbatimit efektiv të sanksioneve ndërkombëtare.

Me qëllim që të sigurojë një nivel adekuat të zbatimit të sanksioneve, DPPP kryen një përditësim të vazhdueshëm dhe publikimin e të dhënave në faqen e saj zyrtare, për të siguruar listën me gjeneralitete të sakta për personat e shpallur mbi bazën e rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB.

Përputhshmëria dhe kontrolli

Një nga detyrat funksionale të DPPP është, mbikëqyrja e nivelit të përputhshmërisë së subjekteve të ligjit me legjislacionin në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Në kuadrin e marrëdhënies së vazhdueshme të bashkëpunimit, aktiviteti institucional është përqëndruar në:

- a) Ofrimin e mbështetjes për subjektet e ligjit në drejtim të identifikimit dhe bllokimit të fondeve ose pasurive të tjera të personave dhe subjekteve të shpallur,
- b) Parandalimin e personave dhe subjekteve të shpallur nga kryerja e transaksioneve nëpërmjet sistemit financiar në Republikën e Shqipërisë;
- c) Përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe procedurave të brendshme, në zbatim të rekomandimeve ndërkombëtare;
- ç) Trajnimit të vazhdueshëm, paraqitjes së treguesve dhe tipologjive;

Niveli i përputhshmërisë kontrollohet në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet inspektimeve në vend apo në distancë dhe bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese të subjekteve respektive. Ekzistojnë gjithashtu procese sipas nenit 21 “Verifikimi i identitetit, i fondeve dhe i pasurive të tjera” të LKMFT për organet mbikëqyrëse për të marrë informacion nga subjektet e detyruara në lidhje me pasuritë që lidhen me personat e shpallur dhe dërgimin e këtij informacioni në DPPP.

REZOLUTAT E OKB

Në vijim paraqiten në mënyrë të përmbledhur rezolutat e miratuara nga KSKB në lidhje me financimin e terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë, në të cilat janë evidentuar dhe çështjet kryesore që adresohen prej tyre.

Rezoluta 1267

Rezoluta 1267 është miratuar në tetor të vitit 1999, në vazhden e rezolutave të mëparshme që kishin të bënin me gjendjen në Afganistan dhe nëpërmjet saj, OKB rikonfirmoi angazhimin ndaj sovranitetit, pavarësisë, integritetit territorial dhe unitetit kombëtar të këtij vendi si dhe respektin për trashëgiminë e tij kulturore dhe historike.

Rezoluta gjithashtu vë theksin në shqetësimin për rritjen e shkeljes së të drejtave të njeriut, prodhimit të lëndëve narkotike, përdorimit të territorit të kontrolluar nga Talibanët, për trajnimin e terroristëve (veçanërisht të Usama Bin Laden) dhe kryerjen e akteve terroriste në nivel ndërkombëtar.

Në funksion të zbatimit të kësaj rezolute është krijuar komiteti 1267, i cili merr në konsideratë kërkesat që paraqiten nga vendet anëtare për listimin e personave të lidhur me terrorizmin apo financimin e tij, ankesat në lidhje me listimin apo bllokimin e fondeve dhe pasurive të tjera të personave të shpallur, si dhe raportet e vendeve anëtare në drejtim të zbatimit të saj.

Kërkesa kryesore për vendet anëtare në kontekstin e kësaj rezolute është ngrirja pa vonesë e fondeve dhe pasurive të tjera të Talibanëve, përfshirë këtu dhe të ardhurat e siguruar nga pasuri në pronësinë e tyre direkte apo indirekte si dhe marrja e masave kundër atyre që shkelin këtë kërkesë.

Rezoluta 1373

Rezoluta 1373 është miratuar në shtator të vitit 2001 dhe disa nga detyrimet kryesore që ajo parashikon për vendet anëtare të OKB janë:

- a) të parandalojnë dhe ndëshkojnë financimin e akteve terroriste;
- b) të dënojnë sigurimin ose mbledhjen e fondeve nga shtetasit e tyre apo në territorin e tyre për kryerjen e akteve terroriste;
- c) të sigurojnë ngrirjen pa vonesë të fondeve dhe pasurive të tjera financiare të personave që kryejnë ose sigurojnë mbështetje në kryerjen e akteve terroriste;
- ç) ndalimin për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të një vendi, të japin çfarëdo lloj shërbimesh financiare apo ndonjë formë tjetër mbështetje për personat e shpallur;
- d) të parandalojnë nëpërmjet kontrolleve efektive të kufirit, lëvizjen e terroristëve ose grupeve terroriste;
- e) të përshpejtojnë dhe intensifikojnë shkëmbimin e informacionit për çështjet e financimit të terrorizmit;

Në zbatim të kësaj rezolute, kërkohet që vendet gjithashtu t'i japin njëri-tjetrit ndihmesën e duhur për hetimin e krimeve ose procedimet penale, që lidhen me financimin ose mbështetjen e akteve Terroriste.

Rezoluta 1452

Rezoluta 1452, është miratuar në dhjetor të vitit 2002 dhe përcakton një sërë përjashtimesh që vendet mund të bëjnë për sa i përket të drejtës për të përdorur fondet e sekuestruara në zbatim të rezolutës 1267, duke marrë në konsideratë krijimin e një procesi objektiv për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mbulimin e

shpenzimeve themelore dhe të jashtëzakonshme dhe duke përcaktuar njëkohësisht detyrimin që vendet anëtare, të komunikojnë dhe të kërkojnë prej OKB miratimin për këtë qëllim.

Rezoluta 1540

Rezoluta 1540, është miratuar në prill të vitit 2004 dhe qëllimi kryesor ishte të ndalonte aktorët jo-shtetëror⁸, nga sigurimi i armëve nukleare, biologjike, kimike dhe sistemet e tyre të dislokimit.

Rezoluta përcaktoi tre detyrime kryesore për anëtarët e OKB të cilat kishin të bënin me

- a) Ndalimin e çdo mbështetje për aktorë jo-shtetërorë që kërkojnë të sigurojnë armë të shkatërrimit në masë dhe mjetet për dislokimin e tyre;
- b) Miratimin dhe zbatimin e ligjeve efektive (p.sh. dënime penale ose civile për shkeljet e ligjeve të kontrollit të eksportit) për të penguar aktorët jo-shtetërorë në përpjekjet e tyre për zhvillimin, prodhimin, posedimin, transportimin, transferimin ose përdorimin e armëve bërthamore, kimike ose biologjike;
- c) Krijimin dhe zbatimin e masave efektive dhe kontrolleve të brendshme (p.sh kontrollet e eksportit) për të parandaluar përhapjen e armëve bërthamore, kimike ose biologjike, mjetet e tyre të shpërndarjes;

Nëpërmjet kësaj rezolute, u adresua një nga mangësitë në ligjet ndërkombëtare që kishte të bënte me rrezikun që lind nga përdorimi i armëve të shkatërrimit në masë nga aktorët jo-shtetëror.

Rezoluta 1718

Rezoluta 1718, u miratua unanimisht nga Këshilli i Sigurimit të OKB në tetor 2006 dhe vendosi një sërë sanksionesh ekonomike dhe tregëtare ndaj Republikës Popullore Demokratike të Koresë (DPRK), pas testit bërthamor të kryer nga ky vend në të njëjtin muaj.

Me anë të kësaj rezolute ndalohej një gamë e gjerë e importeve dhe eksporteve të këtij vendi, si dhe bllokimi i fondeve apo ndalimi i udhëtimit për personat e përfshirë në programin bërthamor. Të gjitha shtetet duhet të bashkëpunonin në funksion të inspektimit të ngarkesave të dyshuara për trafikimin e armëve bërthamore, kimike ose biologjike në vend.

Bazuar në paragrafin 8 (d) të kësaj rezolute, vendet anëtare, “*në përputhje me proceset e tyre përkatëse ligjore, bllokojnë menjëherë fondet, pasuritë e tjera financiare dhe burimet ekonomike që gjenden në territoret e tyre, të cilat janë në pronësi ose të kontrolluara, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga personat ose subjektet e listuara nga Komiteti i Posaçëm apo Këshilli i Sigurimit si të angazhuar në programin bërthamor, armët e shkatërrimit në masë dhe raketat balistike, ose nga persona apo subjekte që veprojnë në emër të tyre ose nën drejtimin e tyre dhe të sigurojnë që fondet, pasuritë financiare apo burime ekonomike në dispozicion të shtetasve të tyre apo ndonjë personi apo subjekti brenda territorit të tyre, ndalohen t’ju ofrohen këtyre personave ose subjekteve.*”

⁸ Një individ apo organizatë që ka influencë të konsiderueshme politike por që nuk është i lidhur me një shtet apo vënd të caktuar.

Rezoluta 1737

Rezoluta 1737, është miratuar në dhjetor 2006 dhe qëllimi kryesor i saj ishte vendosja e sanksioneve ndërkombëtare, me qëllim që të ndalonte programin e pasurimit të uranimit, të ndërmarrë nga Irani. Masat kryesore të parashikuara në këtë rezolutë kishin të bënin me:

- a) Ndalimin e furnizimit të Iranit me teknologji dhe materiale bërthamore;
- b) Bllokimin e pasurive të individëve dhe kompanive kryesore të përfshira në këtë program;

Monitorimi i zbatimit të detyrimeve dhe afateve të përcaktuara në këtë rezolutë, realizohet nga një komitet i posaçëm i ngritur për këtë qëllim.

Rezoluta 1747

Rezoluta 1747, u miratua unanimisht nga Këshilli i Sigurimit në mars të vitit 2007 dhe përforcoi më tej sanksionet e vendosura në lidhje me programin bërthamor të Iranit.

Nëpërmjet paragrafit 6 të saj, rezoluta kërkon nga vendet anëtare ushtrimin e vigjilencës dhe ndalimin e furnizimit, shitjes ose transferimit direkt ose indirekt nga territoret e tyre ose nga shtetasit e tyre ose duke përdorur anijet ose avionët e tyre, të tankeve, automjeteve të blinduara, sistemeve të artillerisë së rëndë, avionëve, helikopterëve, anijeve luftarake, raketave ose sistemeve të tyre si dhe dhënien e ndihmës teknike, trajnimit, asistencës financiare, investimeve, ndërmjetësimit ose shërbimeve të tjera, dhe transferimit të burimeve financiare ose shërbimeve për Iranin.

MASAT PARANDALUESE DHE KOMUNIKIMI

Masat që ndërmerren nga subjektet e ligjit në zbatim të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, kanë një rol primar në nivelin e përputhshmërisë me detyrimet që rrjedhin nga sanksionet dhe rekomandimet ndërkombëtare. Në këtë drejtim, një vend të veçantë kanë procedurat e brendshme për identifikimin dhe verifikimin e klientit, mbajtjen e të dhënave, vlerësimin e rrezikut dhe kategorizimin e klientëve për këtë qëllim, caktimi dhe mirëfunksionimi i personit përgjegjës apo njësisë së përputhshmërisë si dhe trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve.

Në funksion të rritjes së efektivitetit të sistemit parandalues dhe zbatimit rigoroz të sanksioneve ndërkombëtare, kërkohet nga subjektet, veçanërisht nga institucionet financiare dhe profesionet e lira që në vijimësi të përdorin këtë udhëzues:

- a) Për të zbatuar masa strikte në marrëdhëniet e biznesit me vende apo entitete, të konsideruara me rrezik të lartë në nivel ndërkombëtar;
- b) Për të rishikuar rregullat dhe procedurat e tyre të brendshme, në drejtim të kontrollit efektiv të listave të personave të shpallur dhe bllokimit të menjëhershëm të fondeve apo pasurive të tjera;
- c) Për programet e trajnimit të vazhdueshëm që ofrojnë për punonjësit e tyre. Nëpërmjet këtyre trajnimeve subjektet duhet të synojnë rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të drejtuesve, administratorëve dhe punonjësve të tyre për rolet specifike në funksion të parandalimit të financimit të terrorizmit;
- ç) Të rishikojnë vlerësimin e rrezikut të klientëve, dhe në bazë të konkluzioneve të përdorin treguesit e financimit të terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë, siç parashikohen në aneksin e këtij udhëzuesi;

- d) Të mbajnë kontakte të vazhdueshme me DPPP, për të kërkuar asistencën e nevojshme për rastet me ngjashmëri si dhe raportimin e RAD;
- e) Për të dhënë kontributin specifik në kuadrin e vlerësimit kombëtar të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- f) Për të vlerësuar paraprakisht nivelin e rrezikut të produkteve apo shërbimeve të reja;

Bazuar në madhësinë dhe kompleksitetin e shërbimeve që ofrohen nga subjektet, është e rëndësishme që në vlerësimin individual të rrezikut të merren në konsideratë çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e import/eksportit të mallrave me përdorim të dyfishtë dhe mënyra e financimit të tyre, produktet dhe shërbimet që mund të lidhen me tipologji të njohura të financimit të terrorizmit apo industri me rrezik për armët e shkatërrimit në masë, procesin e monitorimit të vazhdueshëm të llogarive apo marrëdhënieve të biznesit të kategorizuara me rrezik të lartë, raportimin dhe bllokimin në kohë të fondeve dhe pasurive të personave të shpallur, etj.

Në funksion të zbatimit efektiv të detyrimeve të bllokimit të fondeve dhe pasurive të personave të shpallur, DPPP i kushton një rëndësi të veçantë komunikimit me sektorin privat, i cili ligjërisht ka dhe detyrimin për të qenë në përputhje me standardet e FATF dhe rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit.

Nëpërmjet këtij komunikimi synohet publikimi dhe shpërndarja në kohë dhe në shkallë të gjerë i informacionit të mëposhtëm për subjektet:

- a) Kufizimet në fuqi për bllokimin e pasurive dhe detyrimet me të cilat ngarkon sektorin privat brenda vendit të identifikojë, bllokojë dhe të sigurohet që fondet dhe pasuritë e tjera nuk vihen në dispozicion të personave të shpallur apo në proces shpallje;
- b) Detyrimet për raportimin e menjëhershëm në DPPP, për fondet dhe pasuritë e tjera të lidhura, për të siguruar bllokimin pa vonesë;
- c) Veprimet e ndërmarra në kuadrin e mekanizmit të bllokimit të pasurive;
- ç) Legjislacionin dhe procedurat e përditësuara në lidhje me mekanizmin e shpalljes së personave dhe bllokimin e fondeve apo pasurive të tjera;

Informimi sipas pikës 'a', mbi identifikimin e të gjithë personave dhe subjekteve që i nënshtrohen mekanizmit të bllokimit të pasurive sipas rezolutave të KSKB, realizohet përmes publikimit në faqen zyrtare (www.fiu.gov.al) të DPPP, të një liste të plotë dhe të përditësuara të të gjithë këtyre personave dhe subjekteve të shpallura.

Informacion i mëtejshëm në funksion të zbatimit të këtij udhëzuesi mund të sigurohet nëpërmjet adresave info@fint.gov.al dhe inspektim@fint.gov.al.

Treguesit e financimit të terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë

Në vijim paraqiten një sërë treguesish që subjektet e ligjit mund të përdorin në funksion të monitorimit të vazhdueshëm të nivelit të përputhshmërisë së tyre me detyrimet për parandalimin e financimit të terrorizmit dhe financimin e armëve të shkatërrimit në masë.

- Klienti është i përfshirë në furnizimin, shit-blerjen e mallrave me përdorim të dyfishtë⁹;
- Adresa e klientit ose personave të lidhur në marrëdhënie biznesi me të është e njëjtë me atë të personave ose subjekteve të përfshirë në listën e sanksioneve ndërkombëtare;
- Klienti është një ushtarak ose institucion kërkimor që është i lidhur me vende me rrezik për financimin e armëve të shkatërrimit në masë;
- Aktiviteti i klientit nuk përputhet me profilin e biznesit;
- Klienti jep përgjigje konfuze në lidhje me palët në transaksione ose marrëdhënie biznesi dhe paraqet rezistencë kur i kërkohet të japë informacion shtesë;
- Klienti përdor struktura komplekse (një seri letrash krediti, kompani guackë , ndërmjetësues ose komisioner nga vende me rrezik, instrumente financiare të panjohura për vëndin në të cilin zhvillon aktivitetin, financimi i projektit përmes kredive komplekse, etj);
- Transaksione që lidhen me mallra me përdorim të dyfishtë veçanërisht nga vende me rrezik;
- Transaksione që përfshijnë persona ose subjekte nga vende me rrezik për armët e shkatërrimit në masë;
- Transaksione që tregojnë se ka një lidhje mes perfaqësuesve të kompanive (p.sh. të njëjtët pronarë ose administratorë) që shkëmbejnë mallra, në mënyrë që të shmangin kontrollin e mëtejshme;
- Transaksione në lidhje me mallra që nuk përputhen me shkëmbimet normale tregëtare mes vendeve.
- Porositë për mallra bëhen nga kompani ose individë nga vende të ndryshme nga ai i përdoruesit final;
- Marrëdhënie biznesi me institucione në vende, me nivel të ulët në zbatimin e rekomandimeve ndërkombëtare apo me mekanizma të dobët të kontrollit mbi importet dhe eksportet;
- Të dhëna të paqarta mbi destinacionin përfundimtar të mallrave me përdorim të dyfishtë apo përdoruesin final;
- Përdorimi i çertifikatave të manipuluar për eksportin e mallrave apo përdorimin e tyre final;
- Përdorimi i kompanive të speditimit si adresë finale për destinacionin e mallrave;
- Udhëzime për transfertat ose pagesat për persona që nuk janë të përfshirë në dokumentacionin origjinal;
- Transferta komplekse të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm nga pikëpamja ekonomike;
- Mospërputhje në informacionin e marrëdhënies së biznesit apo transaksioneve (psh emrat, kompanitë dhe adresat e tyre, destinacioni final);
- Përfshirja e një personi që lidhet me vendet me rrezik;
- Marrëdhënie biznesi për mallra apo pajisje komplekse për të cilat klienti nuk ka eksperiencën përkatëse;
- Përdorimi i pagesave me para në dorë ose metale të çmuara (p.sh ar) në transaksione për produkte industriale;

⁹ Përfshijnë produkte dhe teknologji të cilat përdoren për qëllime civile por që mund gjejnë zbatim dhe për qëllime ushtarake

- Palët në transaksion (pronari, përfituesi, etj.) janë nga vende të njohura për mbështetje të aktiviteteve dhe organizatave terroriste;
- Media raporton se mbajtësi i llogarisë është i lidhur me organizatat e njohura terroriste ose është i përfshirë në aktivitete terroriste;
- Pronari përfitues i llogarisë nuk identifikohet si duhet;
- Përdorimi i llogarive të të nominuarve, trusteeve, anëtarëve të familjes apo palëve të treta;
- Përdorimi i identitetit të rremë;
- Abuzimi me organizatat jo-fitimprurëse;
- Përdorimi i fondeve nga organizata jo-fitimprurëse, nuk është në përputhje me qëllimin për të cilin ajo është themeluar;
- Transaksioni nuk justifikohet ekonomikisht dhe nuk përputhet me biznesin ose profesionin e mbajtësit të llogarisë;
- Kryerja e një sërë transfertash të komplikuar të fondeve nga një person tek tjetri, si një mjet për fshehur burimin dhe qëllimin e përdorimit të fondeve;
- Transaksionet të cilat nuk janë në përputhje me aktivitetin normal të llogarisë;
- Strukturimi i depozitimeve për të shmangur detyrimet e raportimit;
- Transaksione të shpeshta në ATM vendase apo ndërkombëtare;
- Depozita të parave fizike të shumta dhe në shuma të vogla në një llogari bankare, të shoqëruara nga transfertat drejt një vendi tjetër;
- Përdorimi i shumë llogarive bankare të huaja.

Lidhje të rëndësishme

Në vijim paraqiten disa nga faqet e internetit me të dhënat e rezolutave dhe udhëzues për çështjet e financimit të terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë.

Në adresën e mëposhtme subjektet mund të sigurojnë informacion të përditësuar mbi listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB për rezolutën 1267 (dhe rezolutat pasardhëse). Faqja mundëson edhe regjistrimin për të marrë informacion për përditësimet që i bëhen listës.

<https://www.un.org/securitycouncil/sanctions/un-sc-consolidated-list>

Në faqen zyrtare të DPPP publikohen VKM për personat e shpallur mbi bazën e rezolutave 1267 dhe 1373. www.fiu.gov.al

Në faqen e FATF publikohen rekomandimet ndërkombëtare dhe udhëzues në fushën e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë.

<http://www.fatf-gafi.org/>

Në faqen e Komitetit Moneyval të Këshillit të Evropës, publikohen raportet e vendeve anëtare, përfshirë dhe Shqipërinë, në të cilët pasqyrohet niveli i përputhshmërisë me rekomandimet ndërkombëtare të FATF. <https://www.coe.int/en/web/moneyval>